



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT/ TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI/  
PROCUREMENT REVIEW BODY**

**PSH Nr. 60/15**

**PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT** i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, në përbërje prej: z. Ekrem Salihu – Kryetar, Tefik Sylejmani - referues, z. Hysni Hoxha - anëtar pas shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues-Ministria e Shëndetësisë, që OSHP-ja të veproj konform nenit 99 të LPP-së, përkitazi me OE “NTP FRIENDS”, lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me material shpenzues nga L.E. për Lotet: 1,2,3,4,5,6,7,8,10,11,13,14,15,18,19,20,21,22,23,24,25, 27,28,29,30, 31,47,49,50, si dhe për Lotet: 32,33,34,35,36,37,38,39,40,41,42,43,44,45,46”, Me nr.të Prokurimit: 206-14-022-111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “Ministria e Shëndetësisë” – (MSH), më 18 Shkurt 2015, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet**, si e bazuar, kërkesa e Autoriteti Kontraktues (AK) – /Ministria e Shëndetësisë/ – (MSH), e dt: 14.01.2015, për diskualifikim të operatorit ekonomik “NTP FRIENDS”-Prishtinë, nga pjesëmarrja në prokurim publik, si dhe kërkesa për pezullim të kontratës me titull Furnizim me material shpenzues medicinal nga lista esenciale, me nr prokurimi: 206/14/022/111 për Lotet:1,2,3,4,7,8,10,13,14,15,18,19,20,28,29,30,51, e dt:14.11.2014.
- II. Diskualifikohet**, operatori ekonomik “NTP FRIENDS”-Prishtinë, nga pjesëmarrja në prokurim publik, për periudhën njëvjeçare (12 muaj), si dhe pezullohet kontrata me titull “Furnizim me material shpenzues medicinal nga lista esenciale, me nr prokurimi: 206/14/022/111 për Lotet:1,2,3,4,7,8,10,13,14,15,18,19,20,28,29,30,51, e dt:14.11.2014.
- III. Refuzohet**, kërkesa e AK-së, për pezullimin e tri kontratave të mëposhtme, të lidhura në mes të Autoritetit Kontraktues /Ministrisë së Shëndetësisë/ dhe OE “NTP FRIENDS”-Prishtinë, të cilat nuk kanë qenë objekt i shqyrtimit në OSHP:

1). Furnizim me material shpenzues medicinal nga lista esenciale me nr prokurimi: 206/14/049/111, Lotet: 9,10,13,14,15,16,22.

2). Furnizim me material shpenzues medicinal nga lista esenciale me nr prokurimi: 206/13/089/111, Lotet: 1,2.

3). Furnizim me material shpenzues medicinal nga lista esenciale me nr prokurimi: 206/13/012/111, Lotet: 5,6,7,9,10,11,12,14.

## ARSYETIM

Autoriteti kontraktues /Ministria e Shëndetësisë/, me dt:14.01.2015 ka parashtruar kërkesë, në OSHP, që të shqyrtohet mundësia e veprimit konform nenit 99 të LPP-së, për kontratat të cilat ekzistojnë në mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe OE "NTP FRIENDS".

AK-ja, ka njoftuar OSHP-në, se përveç kontratës "Furnizim me material shpenzues medicinal nga lista esenciale, me nr prokurimi: 206/14/022/111 për Lotet:1,2,3,4,7,8,10,13,14,15,18,19,20,28,29,30,51, janë edhe tri kontrata valide, si në vijim:

1). Furnizim me material shpenzues medicinal nga lista esenciale me nr prokurimi: 206/14/049/111, Lotet: 9,10,13,14,15,16,22.

2). Furnizim me material shpenzues medicinal nga lista esenciale me nr prokurimi: 206/13/089/111, Lotet: 1,2.

3). Furnizim me material shpenzues medicinal nga lista esenciale me nr prokurimi: 206/13/012/111, Lotet: 5,6,7,9,10,11,12,14.

OSHP-ja, me dt:21.01.2015, ka kërkuar nga AK-ja /Ministria e Shëndetësisë/ që kërkesa e lartpërmendur të sqarohet dhe të ofrohen dëshmi konkrete, për ti mundësuar OSHP-së, që të veprojë konform nenit 99 të LPP-së. Gjithashtu, OSHP-ja ka kërkuar që të specifikohet qartë në plotësimin e kërkesës, se tri kontratat tjera valide, që janë përmendur në shkresën e dt:14.01.2015, a kanë qenë objekt i shqyrtimit në OSHP, apo jo?

Ministria e shëndetësisë më dt:23.01.2015, ka parashtruar kërkesën tjetër, përsëri të pa precizuar saktë, duke njoftuar OSHP-në, se tri kontratat tjera valide nuk kanë qenë objekt i shqyrtimit në OSHP-ë, dhe duke kërkuar përsëri që të veprohet konform nenit 99 të LPP-së, në lidhje me kontratat të cilat janë valide ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe OE "NTP FRIENDS". Edhe në këtë kërkesë, Ministria e Shëndetësisë, nuk e ka sqaruar mirë se çka kërkon nga OSHP-ja, pasi që neni 99 i përmban tre paragrafe, dhe nuk është saktësuar se në bazë të cilit paragraf është mbështetur kërkesa e tyre.

Kërkesës së lartpërmendur, AK-ja, ja ka bashkangjitur vendimin e Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale me Nr. 01/I/2015 të dt:12.01.2015, dhe vendimin me Nr:10/R-003-15 të dt:12.01.2015, të Inspektoratit Shëndetësor.

Lidhur me kërkesën e lartpërmendur, OSHP-ja ka caktuar seancë dëgjimore me dt:16.02.2015, ku përveç Panelit shqyrtues, kanë marrë pjesë, përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë, përfaqësuesja e Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, përfaqësuesi i OE "NTP FRIENDS", eksperti shqyrtues.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i OE "NTP FRIENDS", kërkojë nga Paneli shqyrtues që seanca të shtyhet, pasi që nuk ka qenë në dijeni se për cilat arsye është ftuar në seancë, dhe se nuk ka asnjë material në lidhje me këtë temë. Kurse Paneli shqyrtues, pas konsultimeve, vendosi të aprovohet kërkesa e përfaqësuesit të OE "NTP FRIENDS", dhe seanca u shty për dt:18.02.2015.

Pas komunikimit të palëve, që të shtyhet seanca, Paneli shqyrtues e obligojë autoritetin kontraktues /Ministrinë e Shëndetësisë/, që para, apo gjatë seancës së radhës, ta precizojë kërkesën e tyre të dt:23.01.2015, meqenëse, e njëjta nuk është e qartë dhe nuk është e precizuar, ashtu siç duhet, konform dispozitave ligjore, pasi që për Panelin shqyrtues ende mbetet e paqartë, se çfarë kërkon konkretisht /Ministria e Shëndetësisë/, pasi që të njëjtit janë thirrur në nenin 99 të LPP-së, i cili nen i përmban tri paragrafe. Paneli shqyrtues kërkojë nga AK-ja, që të precizohen këto elemente, përndryshe, nëse nuk bëhet plotësimi i kësaj kërkesë deri në seancën e radhës, apo gjatë seancës, atëherë ajo do të hudhet poshtë si e palejuar.

Më dt:16.02.2015, AK-ja /Ministria e Shëndetësisë/, ka dërguar në OSHP, një shkresë, si sqarim për lëndën e lartpërmendur, me ç'rast kanë sqaruar se AK-ja, kërkon nga OSHP-ja që të veprohet konform nenit 99 paragrafi 2 i LPP-së, ndërsa nëse Paneli shqyrtues konstaton se nuk ka prova të mjaftueshme, atëherë AK-ja, kërkon që OSHP-ja, të vepron konform nenit 132 paragrafi 1.4 i LPP-së, për arsye se OE "NTP FRIENDS", e ka të pezulluar veprimtarinë nga AKPM-ja, që do të thotë se kontratat e cekura, në kërkesën e dt:22.01.2015, janë të pazbatueshme me OE "NTP FRIENDS".

Më dt:18.02.2015, OSHP-ja ka mbajtur seancën e shtyrë dëgjimore, ku përveç Panelit shqyrtues, kanë marrë pjesë, përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë, përfaqësuesja e Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, përfaqësuesi i OE "NTP FRIENDS", eksperti shqyrtues dhe ekspertja shqyrtuese e OSHP-së.

Gjatë prezantimit në seancë, përfaqësuesi i Ministrisë së Shëndetësisë z. Alban Pozhegu, deklaroi: "ne kemi kërkuar zbatim të nenit 99.2 të LPP-së, në bazë të dokumenteve të parashtruara edhe më herët. me vendimin e AKPM dhe Inspektoratit Shëndetësor, mirëpo nëse ato nuk përmbushin kërkesat për zbatim të nenit 99.2 kërkojmë të zbatohet neni tjetër-132.1.4 i LPP-së, për arsye se licenca i është pezulluar kompanisë nga AKPM-ja, sipas vendimit të dt:12.01.2015 me nr.05-148. Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, kërkojmë suspendimin e gjitha kontratave, që janë të nënshkruara mes autoritetit kontraktues /Ministria e Shëndetësisë/ dhe OE "NTP FRIENDS"- Prishtinë.

Në pyetjen e kryetarit të Panelit shqyrtues, drejtuar përfaqësuesit të AK-së, se a keni prova për t'ia bashkangjitur kërkesës tuaj, në mënyrë që Paneli shqyrtues, për këto prova të merr vendim meritor konform nenit 99.2 të LPP-së.

Përfaqësuesi i AK-së, deklaroj: "kemi prova nga kompania TUV SUD Product Service GmbH e cila bënë lëshimin e ISO certifikatave, e cila ka konstatuar se ISO certifikatat e OE "FRIENDS" janë jo valide që nga viti 2012. Po ashtu kemi deklaratën e kompanisë prodhuese kineze "Anji SPENQ Industrial CO.ltd" përmes së cilës ky prodhues deklaron, se kjo certifikatë është e vet prodhuesit "Anji SPENQ Industrial CO.ltd", e jo e kompanisë angleze Johnson&Friends.

Kryetari i panelit shqyrtues, u interesua të dijë nga përfaqësuesi i AK-së, se provat e prezantuara para panelit shqyrtues, a janë verifikuar dhe a ka ndonjë vendim meritor nga ana e organeve kompetente të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB)-forenzikës, lidhur me provat e prezantuara nga AK-ja.

Në përgjigje, përfaqësuesi i AK-së, Z. Alban Pozhegu deklaroj: "gjatë hulumtimit të AKPM-së dhe Inspektoratit Shëndetësor, prezent kanë qenë edhe inspektorët hetues që kanë nënshkruar procesverbalin e dt:17.12.2014 me nr.004359".

Gjatë vazhdimit të seancës, Kryetari i Panelit shqyrtues pyeti përfaqësuesin e Autoritetit kontraktues /Ministrisë së Shëndetësisë/, se ju në shkresën e datës: 23.01.2015 keni përmendur edhe kontrata tjera valide, të lidhura në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe OE "NTP FRIENDS", keni përmendur vetëm aktivitetet e prokurimit, mirëpo nuk ka data apo çfarë periudhe i përkasin.

Në përgjigje, përfaqësuesi i AK-së, deklaroj: "kontratat janë të periudhave të ndryshme, dhe mund ti ofrojmë panelit kopje të kontratave për shikim".

Kryetari i Panelit shqyrtues, gjatë seancës dëgjimore obligoj përfaqësuesin e AK-së, që të sjellë kontratat e lartcekura me numër dhe data përkatëse.

Gjatë prezantimit në seancë, përfaqësuesja e AKPM-së, znj. Ariana Vitaku, deklaroj: "Si përfaqësuese e AKPM-së, jam ftuar dhe panelit shqyrtues i ofroj si provë materiale, vendimin nr 050 të datës 12.02.2015, si dhe vendimin e Inspektoratit Shëndetësor të datës: 12.02.2015 me nr . 05.-119".

Gjatë prezantimit në seancë, Përfaqësuesi i OE "Friends" z. Armend Selimi, ndër të tjera deklaroj: "Lidhur me kërkesën e AK-së, për pikën 99.2 të LPP-së, në të cilën janë thirrë, e kundërshtojmë sepse konstatimet për dëshmi të rreme nuk qëndrojnë, nuk ka asnjë vendim të gjykatës në formë të prerë "Res Judicata", por ka vetëm një opinion nga Agjencioni Kundër Korrupsionit si dhe një email nga "TUV SUD" i cili interpretohet sipas dëshirës së AK-së dhe AKPM-së. Siç e dini, Agjencioni kundër Korrupsionit ka ra ndesh shumë here me opinione të veta, dhe ky është vetëm opinion. Siç e dinë edhe Ministria e Shëndetësisë, lënda ka qenë në Agjencionin Kundër Korrupsion para nënshkrimit të kontratës, dhe MSH-ja, na kanë thirr për nënshkrim të

kontratës, pa pritë ndonjë opinion prej Agjencisë Kundër Korrupsion. Opinioni i AKK-së, është vetëm opinion, dhe jo vendim i formës së prerë, sipas rrethit 65.3 të LPP-së.

Ndërsa, lidhur me kërkesën e dytë të Autoritetit kontraktues, të cilët kërkojnë ndërmarrjen e masave konform 132 pika 1.4 të LPP, për kompaninë tonë, e kundërshtojmë, sepse i njëjti nen nuk ka të bëjë fare me pezullimin e AKPM-së, siç arsyetohet Autoriteti kontraktues.

Gjithashtu, potencoj se kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë, nuk ka të bëjë fare me nenin 132 për prokurime të mbyllura, ku pika 1.4 thotë "janë dhënë kontrata në kundërshtim me kritere përkatëse të përzgjedhjes, kjo duke ditur se gjatë përzgjedhjes për këtë kontratë ka pas edhe ekspertizë dhe vendimet të OSHP-së, në përputhje me LPP, dhe se vendimi i AKPM ku thirren zyrtar të Ministrisë së Shëndetësisë ndërlidhet me kushtet e përgjithshme dhe kushtet të veçanta të kontratës. Ne kemi kontratë aktuale dhe të cilën Ministria e Shëndetësisë, mund ta shkëpus njëanshëm.

Ne kemi shikuar kushtet e kontratës aktuale mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe NTP FRIENDS me nr.prok.206/14/022/111 të datës: 19.11.2014, edhe atë në nenin 26.1 pika K, ku thuhet "nëse shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që pengon realizimin e kontratës", në rastin tonë prej AKPM -së, e kemi të pezulluar aktivitetin dhe MSH-ja, mund të ndërpret kontratën bazuar në këtë nen".

AK-ja, pas kërkesës së Panelit shqyrtues, me dt:19.02.2015 i ka sjellë në OSHP, tri kontratat valide, të nënshkruara ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe OE "NTP FRIENDS", të cilat nuk kanë qenë objekt i shqyrtimit në OSHP.

Paneli shqyrtues, konstaton se herën e parë, me dt:01.08.2014, AK-ja, ja ka dërguar letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, OE "NTP FRIENDS", me arsyetimin se OE "NTP-FRIENDS", nuk e ka ofruar autorizimin siç është kërkuar në dokumente të tenderit për Lot:1,2,3,4,5,6,7,8,10,11,13,14,15,18,19,20,21,22,23,24,25,27,28,29,30,31,47,49,50, me kompaninë Johnson@Friends, ndërsa është eliminuar me të njëjtat arsye edhe për Lotet: 51,52,53,54, me kompaninë B@D.

Në ankesën e bërë me dt:05.08.2014 nga OE "NTP FRIENDS", si pretendim të vetëm dhe kryesor e ka paraqitur se është eliminuar në mënyrë të padrejtë, në mungesë të vulës në autorizim. Në ankesë OE ankues e ka cekur që ka pasur qasje në dokumentet e tyre, pas eliminimit, ndërsa ka sqaruar se gjatë qasjes, i është thënë nga ana e përfaqësuesit të MSH-së, se është eliminuar për arsye se autorizimi me kompaninë Johnson@Friends dhe autorizimi me kompaninë B@D nuk e përmbajnë vulën. Në ankesë OE ankues e ka cekur gjithashtu, se vula nuk është kërkuar në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë, si element që duhet ta përmbajë autorizimi.

Paneli shqyrtues, e ka aprovuar pjesërisht ankesën dhe ka marr vendim që të kthehet në rivlerësim ky aktivitet i prokurimit për Lotet: 1,2,3,4,5,7,8,10,13,14,15,18,19,20,28,29,30,51 dhe konform nenit 72 të LPP-së, të kërkojnë sqarime dhe informata shtesë nga OE "NTP FRIENDS".

Neni 72 i LPP-së, Nr. 04/L-042 precizon qartë, citojmë: "Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji", mbarim citati. Gjithashtu autoriteti kontraktues / Ministria e Shëndetësisë/, në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë, ka kërkuar, citojmë: "Autorizim nga Prodhuesi (me të dhëna detaje të prodhuesit: adresa, numri i telefonit, emaili etj, në mënyrë që Autoriteti Kontraktues, të ketë mundësi për verifikim)", mbarim citati. Prandaj, duke u bazuar në kërkesën e lartpërmendur të autoritetit kontraktues, si dhe duke u bazuar në nenin 72 të LPP-së, Paneli shqyrtues ka marr vendimin Nr. 283/14 të dt:08.09.2014.

Paneli shqyrtues, me dt:03.03.2015, ka kërkuar nga AK-ja që dokumentet e ofruara në Gjuhen Angleze, të përkthehen dhe të ofrohen si dëshmi në gjuhën shqipe, me qëllim që Paneli shqyrtues, ti ketë të qarta të gjitha dëshmitë, për të marr një vendim meritore në lidhje me kërkesën e AK-së.

Kurse me dt: 04.03.2015, përfaqësuesi i AK-së, z. Alban Pozhegu, ka kthyer një përgjigje në mënyrë elektronike, ku ka theksuar se gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës janë Gjuha Shqipe, Angleze dhe Serbe, kurse Ministria e Shëndetësisë nuk ka përkthyes të licencuar për këto përkthime dhe sa për informatë dokumentacioni i plotë gjendet në Policinë e Kosovës, gjegjësisht në krime ekonomike.

Paneli shqyrtues, kërkesën e autoritetit kontraktues për diskualifikim nga pjesëmarrja në aktivitete të prokurimit të OE "NTP FRIENDS"-Prishtinë, e aprovon si të bazuar për faktin se operatorit ekonomik në fjalë, me vendimin e Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale me Nr.01/I/2015 të dt:12.01.2015, i është pezulluar licenca L1PM/2012/10/046 e dt:19.05.2014, derisa organet kompetente të qartësojnë validitetin e certifikatave të konformitetit, përkritazi me importin dhe qarkullimin në Republikën e Kosovës, për pajisjet medicinale. Poashtu me vendimin e Inspektoratit Shëndetësor, Nr:10/R-003-15 të dt:12.01.2015, Operatorit ekonomik "NTP FRIENDS", i është ndaluar ushtrimi i veprimtarisë, përkohësisht, për shkak të dyshimit, se certifikatat e konformitetit janë të falsifikuara.

Sa i përket kërkesës së AK-së, që të veprohet konform nenit 132 paragrafi 1.4 i LPP-së, për tri kontratat e nënshkruara ndërmjet AK-së, dhe OE "NTP FRIENDS", e të cilat janë në ekzekutim e sipër, por të cilat nuk kanë qenë objekt i shqyrtimit të OSHP-së, Paneli shqyrtues sqaron se këto aktivitete të prokurimit nuk kanë qenë objekt i shqyrtimit të OSHP-së, dhe se Paneli shqyrtues nuk ka dijeni dhe njohuri, nëse këto kontrata janë lidhur në kundërshtim me kriteret përkatëse të përzgjedhjes, kërkesat dhe specifikimet ose në përputhje me kriteret e përzgjedhjes, kërkesat ose specifikimet që nuk janë të përgatitura ose publikuara në pajtim me këtë ligj, dhe se shkëputja e këtyre kontratave është përgjegjësi e palëve kontraktues, në relacionin e marrëdhënieve detyimore, duke u bazuar në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratave të nënshkruara ndërmjet këtyre dy palëve kontraktuese.

Për tri kontratat në fjalë, autoriteti kontraktues, për më tepër duhet ti referohet draft kontratës- formularit të dosjes së tenderit, për furnizim, të publikuar në KRPP, si dhe Ligjit mbi marrëdhëniet detyimore të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-077 të

dt:10.05.2012.

Paneli shqyrtues, dokumentin e ofruar nga AK-ja, e të lëshuar nga ANJI SPENQ INDUSTRIAL CO,LTD, nuk ka mundur ta deshifrojë, pasi që nuk shihet mirë në disa pjesë, të cilat janë të shlyera, dhe nuk janë përkthyer nga ana e AK-së, por janë përkthyer nga OSHP-ja, aq sa janë vërejtur.

Paneli shqyrtues, ka shqyrtuar gjithashtu vendimin e Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale me Nr.01/I/2015 të dt:12.01.2015, dhe vendimin me Nr:10/R-003-15 të dt:12.01.2015, të Inspektoratit Shëndetësor, me të cilat vendime është pezulluar dhe është ndërprerë përkohësisht veprimtaria e OE "NTP FRIENDS".

Gjithashtu Paneli shqyrtues shqyrtojë edhe emailin e dt:04.12.2014 të dërguar nga znj. Fulgieri nga TUEV SUEDE, e cila përmes emailit dërguar z. Dukagjin Zabergja, me ç'rast ka sqaruar, citoj: "me mirësi ju informojë se certifikata e kërkuar nr. Q1N 100773111001 (JOHNSON&FRIENDS Group Corporation, Tangpu Economic Development Zone, 313300 Anji City, provinca Zhejiang) është e pavlefshme, tashmë për shkak të zëvendësimit nga certifikata pasuese", mbarim citati.

Lidhur me këtë email, Paneli shqyrtues, nuk ka mundur të vendos në mënyrë meritore, në mungesë të informatave të sakta nga ana e autoritetit kontraktues, sepse kërkesës së autoritetit kontraktues nuk i është bashkangjitur raporti i rivlerësimit dhe në rastin konkret, ne nuk e dimë se çfarë certifikata pasuese janë valide dhe çfarë certifikatash ka ofruar me dosje të tenderit OE "NTP FRIENDS".

Periodha kohore e masës për diskualifikim do të mbetet në fuqi, për një periudhë një vjeçare.

Kjo masë-diskualifikimi, mund të revokohet në momentin kur autoriteti kontraktues ose operatori ekonomik "NTP FRIENDS" i ofrojnë dëshmi me shkrim, Panelit shqyrtues se organi kompetent i MPB-së-forenzikës, si dhe Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale dhe Inspektorati Shëndetësor, kanë vërtetuar në mënyrë meritore se operatori ekonomik i diskualifikuar nuk ka bërë falsifikime të dokumenteve apo nuk ka ofruar dëshmi të rrejshme.

Paneli shqyrtues, nga të cekurat më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

#### **Këshillë Juridike:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur nuk mund të ushtron ankesë, por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh, pas pranimit të këtij vendimi, me kërkesë-padi mund ti drejtohet. Departamentit për çështje Administrative, në Gjykatën themelore në Prishtinë.

Kryetari i Panelit Shqyrtues  
Z. Ekrem SALIHU